10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Kontakt: (Shembull)

DATA ME RËNDËSI: (Shembull)

- **4 prill 2009:** Pranimi i temave dhe abstrakteve
- **10 korrik 2009:** Dorëzimi i punimeve (të plota)
- **1 Shtator 2009:** Publikimi i agjendës së konferencës
- **14/15 Shtator 2009:** Konferenca

FORMA – 5-C

WORK PACKAGE ASSIGNMENT SHEET

	Project name:						Project Manager		
	Activity		Schedule		Resource				
No.	Name	Description	Start	End	Money	Materials	Responsib.	Realisat.	Coment



Bartësi Privat i Arsimit të Lartë
Private Bearer of Higher Education

ALMA MATER EUROPAEA CAMPUS COLLEGE REZONANCA



FORMA - 6

VLERËSIMI I ORGANIZIMIT TË TAKIMIT SHKENCOR ME TITULL

“[\[Kliko këtu dhe shëno TITULLIN E TAKIMIT SHKENCOR\]](#)”

[\[Kliko këtu dhe shëno VITIN\]](#)

Prishtinë

LËNDA: VLERËSIMI I ORGANIZIMIT TË TAKIMIT SHKENCOR

Titulli i takimit: "[Kliko këtu dhe shëno TITULLIN E TAKIMIT]"

PARASHTRUESI I
KËRKESËS: [Kliko këtu dhe shëno PARASHTRUESIN]

DREJTUAR: KËSHILLIT SHKENCOR TË INSTITUTIT

Këshilli i Fushës Shkencore _____ për vlerësim të kërkesës për ORGANIZIM TË TAKIMIT SHKENCOR ka shfrytëzuar metodologjinë e vlerësimit sipas parimeve të përgjithshme të hartimit të planit organizativ të takimit dhe sipas vlerësimit të pjesëve përbërëse të Propozimit, e me qëllim të sigurimit të gjykimit racional dhe kuantifikimit të tij si: a) I pranueshëm; b) Pjesërisht i pranueshëm dhe c) I pa pranueshëm për realizim.

A. KRITERET E PËRGJITHSHME PËR VLERËSIM

1. TITULLI I TAKIMIT SHKENCOR:
2. OBJETIVAT E TAKIMIT
3. RËNDËSIA E TAKIMIT SHKENCOR
4. KUALIFIKIMET E PARASHTRUESVE TË KËRKESËS
5. PËRMASAT E TAKIMIT
6. RACIONALITETI I ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TË TAKIMIT SHKENCOR
6. PERIUDHA E ORGANIZIMIT, KOHËZGJATJA DHE LOKACIONI

B. VLERËSIMI I PLANIT FINANCIAR DHE I BURIMEVE TË FINANCIMIT

VLERËSIMI

1. VLERËSIMI I TITULLIT TË TAKIMIT:

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

2. OBJEKTIVAT E TAKIMIT SHKENCOR JANË:

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

3. RËNDËSIA E TAKIMIT SHKENCOR:

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

3. KUALIFIKIMET E PARASHTRUESVE TË KËRKESËS (KOMPETENCA PROFESIONALO-SHKENCORE)

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

a. Kryetar i Këshillit organizativ – propozohet:

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

b. Zëv.kryetar i Këshillit organizativ – propozohet:

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

c. Anëtarët e Këshillit organizativ:

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

4. PËRMASAT E TAKIMIT (ndërkombëtare, nacionale, kombëtare, etj.)

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

5. RACIONALITETI I ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TË TAKIMIT SHKENCOR

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

6. PERIUDHA E ORGANIZIMIT, KOHËZGJATJA DHE LOKACIONI

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

7. PLANI FINANCIAR DHE BURIMET E FINANCIMIT

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

8. BURIMET E FINANCIMIT

[Kliko këtu dhe shëno VLERËSIMIN]

KOMENTI

Në përgjithësi, në bazë të vlerësimit, TAKIMI SHKENCOR vlerësohet si:

- I PRANUESHËM PËR REALIZIM
- PJESËRISHT I PRANUESHËM PËR REALIZIM
- I PA PRANUESHËM PËR REALIZIM.

REKOMANDIMET:

[Kliko këtu dhe shëno REKOMANDIMET]

Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës

.....

Vendi Prishtinë, Datë

Bartësi Privat i Arsimit të Lartë
Private Bearer of Higher Education



ALMA MATER EUROPAEA CAMPUS COLLEGE REZONANCA



**UDHEZUES PER PLOTESIMIN E PROJEKT-PROPOZIMIT
TE HULUMTIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR (FORMA - 2)**

Prishtinë, 2021

1. PROJECT OVERVIEW

Një projekt propozim hulumtimi është një përshkrim i qartë dhe i detajuar i një studimi, i cili do të hetojë një problem të dhënë. Në këtë projekt propozim përfshihet vendosja e qëllimit të hulumtimit, arsyetimi për hipotezat e ngritura, ose sqarimi për pyetjen qëndrore të hulumtimit, objektivat e përgjithshme apo specifike të projekt propozimit, ofrohen informacionet rreth aspektit administrativ të proket propozimit, shpjegohet problemi hulumtues dhe arsyeshmëria e realizimit të këtij projekt propozimi, përcaktohet qasja metodologjike e realizimit të hulumtimit si dhe përcaktohet buxheti dhe periudha kohore të nevojshme për realizimin e tij.

Një projekt propozim siguron, udhëheq, tregon rrugën e zhvillimit të një hulumtimi që në momentin e miratimit të tij deri në prezantimin apo publikimin e rezultateve të tij, është një proces vital dhe influencon fuqishëm suksesin e projektit.

TITULLI:

Pavarësisht llojit të hulumtimit, titulli duhet të jetë i qartë, i saktë në aspektin përmbajtjesor dhe gjuhësor, specifik në përmbajtjen e tij, informativ, domethënës, tërheqës, aktual dhe etik. Pa cënuar përmbajtjen e punimit, titulli rekomandohet të jetë sa më i shkurtër dhe duhet të përshkruajë sa më qartë që të jetë e mundur qëllimin e hulumtimit.

Metodologët bashkëkohorë vlerësojnë se formulimi i problemit për hulumtim, përcaktimi i titullit të projektit hulumtues, shpesh është më esencial edhe se vetë zgjidhja e tij, e cila mund të jetë çështje e shkathtësisë eksperimentale apo matematikore. Prandaj të inicosh pyetje të reja, të zbulosh mundësi të reja, të shikosh problemet reale nga këndvështrime të reja, kërkon imagjinatë krijuese por njëkohësisht edhe punë të palodhur, lexim të pandërprerë, të qënë në hap me hulumtimet apo studimet e fundit në fushën e studimit tuaj.

BUXHETI I VLERËSUAR:

Në këtë rubrikë shënohen në mënyrën më të qartë të mundshme shuma e buxhetit të përafërt të nevojshëm për realizimin e projektit.

KOHËZGJATJA E PLANIFIKUAR:

Ka të bëjë me përcaktimin e kohës në të cilën apo gjatë së cilës do të ndodhë tërë ecuria e hulumtimit. Gjatë përpilimit të projektit shënoni më tepër kohë se që mendoni që do të zgjasë projekti juaj. Kjo periudhë kohore përfshin momentin e miratimit të projekt propozimit tuaj deri në publikimin apo prezantimin e rezultateve të këtij projekti.

Rekomandohet të bëhet një paraqitje tabelare e planifikimit kohor, në të cilën të specifikohen aktivitetet e vecanta të projektit dhe periudha kur ato duhet të zhvillohen.

QËLLIMI I HULUMTIMIT:

Këtu duhet të shkruhet qartë qëllimi i projektit tuaj hulumtues.

OBJEKTIVAT:

Në mënyrë të përmbledhur shkruhen objektivat e projektit hulumtues, të cilat plotësojnë qëllimin kryesor të tij. Objektivat e përgjithshëm ose specifikë shkruhen në paragrafë të vecantë, në funksion të qartësisë së përmbajtjes së tyre.

ABSTRAKTI:

Abstrakti, është një përmbledhje që përshkruan aspektet më të rëndësishme të projekt propozimit, që përfshin hetimin e problemit, pjesëmarrësit dhe instrumentet që do të përdoren, dizajnin e hulumtimit, procedurat e zhvillimit të tij dhe rezultatet e pritshme. Zakonisht është pjesë përbërëse e një projekt propozimi dhe përmban nga 80 - 100 fjalë. Abstrakti duhet të shërbejë si "zëvendësim" i projektit tuaj, pra të përmbajë esencën e punimit. Mos citoni referenca në abstrakt.

2. INFORMATA ADMINISTRATIVE**UDHËHEQËSI I PROJEKTIT:**

Në këtë rubrikë shënohen të dhëna të sakta dhe të plota për udhëheqësin e projektit kërkimor. [Emri mbiemri, afiniteti institucional, Grada shkencore, thirrja akademike, nr. i telefonit, adresa e e-mailit]

INSTITUCIONI REALIZUES:

Shkruani informacionin e plotë dhe të saktë për institucionin i cili do të bëjë realizimin e projektit tuaj. Këtu përfshihen emri dhe lloji i institucionit.

INSTITUCIONET BASHKËPUNUESE:

Në këtë rubrikë shkruhen të dhënat për institucionet e tjera të cilat bashkëpunojnë profesionalisht në realizimin e projektit, të cilat mund të jenë apo edhe të mos jenë partnerë në financimin e tij.

INSTITUCIONET PARTICIPUESE:

Duhet të shënohen të dhënat e plota dhe të sakta për institucionet të cilat marrin pjesë në financimin e realizimit të projektit, si dhe përqindja apo sasia e kontributit të tyre financiar në projekt.

DONATORËT E TJERË:

Shënohen të dhënat për të gjitha institucionet e tjera të cilat kontribuojnë në cilëndo mënyrë në realizimin me sukses të projektit, duke specifikuar mënyrën e kontributit.

DOKUMENTAT E TJERË ADMINISTRATIVË MBËSHTETËSE:

3. PROBLEMI HULUMTUES DHE JUSTIFIKIMI

RELACIONET E PROJEKTIT ME PRIORITETET ZHVILLIMORE TË SHETIT:

Projektet kërkimore shkencore kanë si qëllim të tyre kryesor ofrimin e një sistemi dijesh dhe njohurish të formësuar duke vëzhguar, studiuar botën reale dhe jetën dhe duke bërë përgjithësime teorike (për një fushë apo degë të caktuar) apo edhe shpjegimin, parashikimin dhe /ose kontrollimin e dukurive, fenomeneve etj.

I parë në këtë këndvështrim, në këtë rubrikë përshkruani me përpikmëri lidhjen në ekziston ndërmjet projektit tuaj hulumtues dhe prioriteteve zhvillimore të fushës përkatëse në të cilën është fokusuar studimi juaj. Sqaroni në cilat dimensione plotësojnë njëri-tjetrin, dhe përfitimet përkatëse.

Më poshtë janë disa rekomandime rreth vecorive që e kushtëzojnë zgjedhjen dhe përcaktimin e temës së projekteve hulumtuese :

- **Risia** – gjatë zgjedhjes së problemit të hulumtimit, është e rekomandueshme që të eliminohen përsëritjet e hulumtimeve tashmë të zhvilluara, përveçse në rastet kur duam të vlerësojmë nëse të arriturat / rezultatet e atyre hulumtimeve janë të vlefshme edhe në kohën aktuale. Cdo hulumtim i ri duhet të përmbajë në vete risi në teorinë që përfaqëson, duke përmirësuar këtë teori apo duke ofruar zgjidhje të reja për probleme të ndryshme praktike
- **Vlerësimi i rëndësisë së hulumtimit** – hulumtimet e ndryshme kanë peshë, arsyeshmëri dhe zbatueshmëri të ndryshme në hapësirë dhe kohë të caktuar, prandaj njohja dhe vlerësimi i drejtë i kësaj duhet pasur parasysh në zgjedhjen e temës së hulumtimit.
- **Niveli i interesimit** – secili hulumtim është një proces që shoqërohet me vështirësi të ndryshme, shpeshherë të paparashikuara, të cilat një hulumtues me interesim jo të mjaftueshëm në temën që ka zgjedhur, mund ta detyrojnë të heqë dorë nga hulumtimi i tij.
- **Aftësia profesionale** - meqënëse secili prej nesh e zgjedh temën e tij të studimit nga lëmia përkatëse e përgatitjes së tij profesionale, niveli i kësaj përgatitjeje jo vetëm i yni por edhe i kolegëve apo bashkëpunëtorëve tanë, i shoqëruar ngushtë me karakteristikat e një hulumtuesi shkencor si dëshira, këmbëngulja, vullneti, ambicia etj shpesh shihet si një element i rëndësishëm në zgjedhjen e temës së hulumtimit
- **Koha** – pavarësisht nëse mund të jetë longitudinal apo transversal, hulumtimi ka nevojë për kohën e vet të mjaftueshme, të cilën shpesh mund ta planifikojmë por shpesh hulumtimi mund të kërkojë më tepër kohë, të cilën hulumtuesi/t duhet ta respektojë dhe ta ketë parasysh në zgjedhjen e temës së tij të studimit.
- **Aktualiteti i rezultateve të hulumtimit** – mund të ndodhë që kur ne bëjmë publikimin e rezultateve të hulumtimit tonë, ato nuk janë më aktuale, sepse procesi që ne kemi hulumtuar tashmë ka përfunduar

RËNDËSIA SHKENCORE E PROJEKTIT:

Nëse i referohemi përkufizimit të termit kërkim / hulumtim, i cili ka të bëjë me gjurmimin sistematik të fakteve nga të cilat mund të nxirren parimet dhe ligjshmëritë e caktuara

shkencore, e në pajtim me këtë, faktit që shkencën në të vërtetë e përbëjnë rezultatet, ligjet deri tek të cilat vihet me anë të kërkimeve, në këtë rubrikë sqaroni në mënyrën më të thjeshtë dhe më të saktë të mundshme ku qëndron rëndësia shkencore e projektit tuaj.

PËRMASAT E PROBLEMIT DHE NDIKIMI I PROJEKTIT NË ZGJIDHJEN E SAJ:

Në këtë rubrikë bëhet një shpjegim i qartë dhe i saktë i problemit të identifikuar për hulumtim / kërkim të mëtejshëm, sqarohen përmasat e këtij problemi në kontekstin përkatës, si dhe sqarohet si do të ndikojnë rezultatet e pritshme të projektit tuaj në zgjidhjen e problemit tuaj të hulumtimit, a do të ketë përfitime teorike nga ky projekt apo përfitimet do të jenë të nivelit praktik etj.

RËNDËSIA SPECIFIKE E PROJEKTIT PËR GRUPET ME INTERES:

Këtu duhet të përmendni grupet [ëpopullatat] me interes të cilat drejtpërdrejt do të përfitojnë nga zhvillimi i projektit dhe rezultatet e pritshme të tij. Jini sa më të qartë në përshkrimin tuaj.

4. OBJEKTIVAT

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME:

OBJEKTIVAT SPECIFIKE:

5. METODOLOGJIA

KORNIZA KONCEPTUALE DHE TEORIKE:

Kjo rubrikë i referohet ndërtimit të kornizës konceptuale dhe teorike të projektit. Në të duhet të përfshihet sqarimi se si ky projekt dhe rezultatet e tij do të kontribuojnë një teorie ekzistuese, një sistemi të politikave në një fushë të caktuar apo zgjidhjes së një problemi praktik, duke bërë përcaktimin e problemit hulumtues në kontekst më të gjërë. Pjesë e kësaj rubrike është edhe informacioni i mbledhur gjatë procesit të rishikimit të literaturës, i cili zakonisht krijon mundësinë për të strukturuar dhe përcaktuar dhe kornizën e pyetjes qendrore të projektit, dhe përcaktimin e qasjes së studimit.

PJESËMARRËSIT:

Përfshin përshkrimin e hollësishëm dhe të qartë të të dhënave në lidhje me mostrën që do të hulumtohet, si numri, burimi, karakteristikat specifike, arsyeshmërinë e zgjedhjes së saj, por njëkohësisht përshkruani edhe popullatën prej nga është marrë mostra e hulumtimit .

INSTRUMENTET QË DO TË PËRDOREN:

Kjo pjesë përfshin përshkrimin e saktë të instrumenteve që do të përdoren si dhe mënyrës si do të masin ndryshoret e përcaktuara në projekt hulumtim. Një instrument është një test ose mjet përmes të cilit bëhet grumbullimi i të dhënave të hulumtimit. Nëse në hulumtimin tuaj do të përdorni një instrument tashmë të standardizuar, ju duhet të përshkruani përputhshmërinë e këtij instrumenti me studimin dhe popullatën tuaj, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tij, dhe procesin e administrimit dhe të vlerësimit (pikëzimit) të tij.

Por, nëse ju jeni duke përdorur një instrument të ri, tuajin, ju duhet të përshkruani se si do të zhvillohet ky instrument, çfarë do të masë, si do të masë, si do të përcaktoni vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tij, dhe si është i lidhur ky instrument me hipotezën dhe mostrën e hulumtimit tuaj. Nëse në projektin tuaj përcaktoheni që të përdorni më shumë se një instrument, atëherë secili prej tyre duhet të përshkruhet në mënyrë të detajuar, edhe pse duhet thënë që në këtë fazë, mund të mos jeni në gjendje të bëni përshkrimin e detajuar të këtyre instrumenteve.

GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE:

Në këtë rubrikë duhet të përshkruani qartë dhe me detaje mënyrën që do të shfrytëzoni për sigurimin e të dhënave të projektit tuaj, po ashtu kohën, vendin dhe nga kush është bërë grumbullimi i të dhënave.

Të gjitha llojet e hulumtimeve shkencore kërkojnë dhe e përmbajnë mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë pjesë e informacionit që ne mbledhim dhe përdorim për të ekzaminuar një pyetje hulumtuese apo për të vërtetuar ose rrëzuar një hipotezë të ngritur. Metoda shkencore është e bazuar pikërisht në mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e këtyre të dhënave. Ekzistojnë tre rrugë kryesore në grumbullimin e të dhënave kërkimore :

1. Administrimi i një instrumenti të standardizuar
2. Administrimi i instrumenti të krijuar nga vetë hulumtuesi
3. Regjistrimi i natyrshëm / regjistrimi i të dhënave tashmë të gatshme

Ekzistojnë disa qindra instrumente të standardizuara apo jo të standardizuara të cilat mund të përdoren nga secili hulumtues. Një test i standardizuar quhet ai test që është i administruar, i pikëzuar dhe interpretuar në të njëjtën mënyrë, pavarësisht kur dhe ku është përdorur.

MENYRA E ZBATIMIT TE HULUMTIMIT

Duhet të përmbajë të gjitha hapat sipas të cilave do të zhvillohet hulumtimi prej fillimit deri në fund, procedurë kjo që ndryshon në qasjen sasiore dhe qasjen cilësore të projekteve kërkimore. Këto hapa duhet të sqarohen me saktësi sepse ndryshojnë në varësi të llojit të studimit.

Në këtë pjesë duhet të përfshihen edhe supozimet dhe limitet e hulumtimit. Një supozim është një 'fakt' që prezupozohet të jetë i vërtetë po nuk është verifikuar ende si i tillë, ndërkohë që limitet janë aspekte të vecanta të hulumtimit për të cilat hulumtuesi është i vetëdijshëm që mund të ndikojnë në rezultatet e hulumtimit.

Është shumë e rekomandueshme që kjo pjesë e projektit të jetë precize në atë pikë që kushdo që e lexon, të mund ta zhvillojë projektin tuaj ashtu si do ta kishit zhvilluar edhe ju vetë.

ANALIZA E TË DHËNAVE:

Analizimi i të dhënave është një përpjekje e hulumtuesit për të përgjithësuar të dhënat e mbledhura në një mënyrë të kujdesshme dhe të besueshme. Është prezantimi i të gjeturave të hulumtimit në mënyrë të pamohueshme dhe të padyshtimtë.

Secili projekt hulumtim duhet të përmbajë edhe pjesën e analizimit të të dhënave, në të cilën duhet të përshkruhen të gjitha teknikat që do të përdoren për të analizuar të dhënat e mbledhura. Në shumicën e hulumtimeve, kërkohen disa metoda statistikore që do të përdoren gjatë analizës së të dhënave. Zgjedhja e këtyre teknikave varet nga një seri faktorësh si numri i grupeve që hulumtohen, numri i ndryshoreve në hulumtim, lloji i të dhënave që kemi mbledhur etj. Megjithëse ndoshta ende nuk jeni njohur apo familjarizuar me morinë e teknikave të nevojshme për analizimin e të dhënave, në projektin tuaj ju sigurisht duhet të përshkruani llojin e analizës që do të zhvilloni.

6. REZULTATET DHE DISEMINIMI

Kjo rubrikë duhet të përmbajë rezultatet e pritshme të projektit tuaj. Përshkruani qartë cilat janë pritshmërinë e projektit tuaj dhe arsyeshmërinë e tyre.

7. STAFI REALIZUES I PROJEKTIT ME KUALIFIKIMET DHE TERMAT E REFERENCAVE

Në këtë rubrikë shënohen të dhëna të plota për të gjithë anëtarët e stafit realizues të projektit, duke përfshirë emrin mbiemrin, gradën shkencore, thirrjen akademike, afinitetin institucional, pozitën dhe detyrat në stafin hulumtues, numrin e telefonit, adresën e e-mailit.

8. ORARI I ZBATIMIT DHE BUXHETI

ORARI DHE KOHËZGJATJA:

Rekomandohet të bëhet një paraqitje tabelare e planifikimit kohor, në të cilën të specifikohen aktivitetet e vecanta të projektit dhe periudha kur ato duhet të zhvillohen.

BUXHETI (PLANI FINANCIAR)

Punohet plani i detajuar financiar sipas kategorive të shpenzimeve në formë tabelare.

Shuma e përgjithshme duhet të prezantohet e ndarë në vija buxhetore, të cilat mbulojnë aspekte apo etapa të vecanta të realizimit të projektit.

ëShembull : Përshkruani koston e të ardhurave të personelit dhe informata të përfitimit dytësor dhe shpenzimet e tjera personale të shërbimit, shpenzimet e udhëtimit, postës, furnizimit, sigurimit të instrumenteve etj. Përfshini kostot e projektit që duhet paguar gjatë implementimit të programit. Paraqitni veçmas listën e të gjitha shërbimeve të tjera në bazë të donacioneve duke përfshirë vullnetarët dhe kostot indirekte aty ku është e mundur duke justifikuar sa duhet performancën e punëve të përshkruara.]

9. ANEKSET

Këtu duhet të shënohen të gjitha materialet e rëndësishme që do të përdoren gjatë studimit, p.sh. pyetësorë, të dhëna të papërpunuara, forma për pjesëmarrjen në studim, forma të analizës së të dhënave etj.

10. BIBLIOGRAFIA

Bibliografia përfundimtare, është një pjesë e domodoshme e çdo projekti dhe zakonisht vendoset para pjesës së shtojcave të punimit (nëse ka shtojca).

Bibliografia duhet të përmbajë të gjitha burimet dhe shkrimet që ju keni përdorur dhe do të përdorni në çfarëdo mënyre në punën tuaj. Ky listim i burimeve të përdorura bëhet në mënyrë alfabetike, sipas mbiemrit të autorit/ëve. Ato burime të cilat nuk kanë autor (enciklopedi, filma etj) duhet të alfabetizohen sipas titullit të tyre. Çdo burim i cituar në projekt, duhet të jetë i përfshirë edhe në listën e referencave / bibliografisë dhe anasjelltas.

SHTOJCA 1

Rregulla të përgjithshme të të shkruarit :

- Një nga rregullat më kryesore në procesin e të shkruarit të projekteve është sigurimi i lidhjes dhe harmonisë së përmbajtjes dhe tërësisë së idesë së projektit.
- Projekti duhet të jetë i shkruar në mënyrën më të qartë, më të thjeshtë, më të hapur, duke respektuar rregullat e gjuhës dhe shenjat e pikësimit.
- Respektoni formën e ofruar standarde të institucionit në të cilin po konkuroni me projektin tuaj. ëI.K.SH.]

Forma dhe stili i të shkruarit.

- Shumica e raporteve, projekteve përgjithësisht ndjekin një sistem të zgjedhur për formën dhe stilin e të shkruarit. Forma i referohet modeleve të përgjithshme të organizimit dhe përgatitjes së raportit. Stili i referohet zbatimit të rregullave të gramatikës, përdorimit të shkronjës së madhe, shenjave të pikësimit, respektimit të satndarëve të vendosura për punime të tilla etj.
- Përdorni gjithmonë dhe pa përjashtim stilin 'Standard' në brendinë e punimit tuaj. Mos luani me brendinë e punimit tuaj duke përdorur stile apo fonte të ndryshme për paragrafe të veçanta.
- Shënoni numrat e faqeve të projektit, duke respektuar vendosjen e numrit në anën e djathtë të faqes lart. Numrat fillojnë në faqen ku fillon trugu i projektit. Në faqet që përmbajnë shtojcat, nuk vendosen numrat.
- Përdorimi i 'Headers' and 'Footers' nuk është shumë i rekomandueshëm dhe i nevojshëm.

➤ Respektojeni rregullën e stilit 'Standard' në shkrimin e shenjave të pikësimit, si ; , ? !] }) etj, sipas të cilit : *asnjëherë* mos përdor një hapësirë para tyre, por *gjithmonë* përdorni një hapësirë pas tyre. Gjithashtu për kllapat hapëse ({ , asnjëherë mos përdorni një hapësirë pas tyre, por gjithmonë përdorni një hapësirë para tyre.

➤ Përdorni gjithmonë vetëm një hapësirë përpara dhe pas shenjave < > = etj.

➤ Përpiquuni të shmangni sa më shumë që të jetë e mundur shkrimin brenda kllapave.

➤ Nëse shkronja e parë e një fjalie është numër, ose nëse ky numër është nëntë e më pak, këto numra zakonisht shprehen me fjalë. Përndryshe numrat janë të gjithë të shprehur si shifra *Arabic* (Katër grupe u organizuan; u plotësuan gjithsej 256 pyetësorë)

➤ Referencat e punimit shkruajini në të njëjtën formë. Ndajini autorët me pikëpresje (Bredenkamp & Copple 1997; Shala 2007). Në rastet kur për një referencë ka më tepër se një autor, shkruhet vetëm mbiemri i autorit të parë dhe më pas 'e të tjerë' (McKenzie e të tjerë 1997). Sidoqoftë në rastet e publikimit të rezultateve të projektit tuaj, do të referoheni kërkesave të revistës përkatëse.

➤ Çdo referencë e juaja që është e shkruar në brendinë e projektit propozimit, duhet të jetë edhe në listën në fund të projektit dhe anasjelltas.

➤ Shkruani qartë dhe saktë, duke dhënë thelbin, esencën e përmbajtjes. Mos përdorni fjali shumë të gjata ërrezikoni të humbni kuptimin e asaj çfarë keni dashur të thoni]. Mundohuni gjithashtu të shmangni dykuptimësinë në fjalët dhe fjalitë që përdorni.

➤ Paraqitja e ideve paralele në fjali duhet të shprehet duke respektuar konstruktionet paralele gramatikore.

➤ Gjatë gjithë punimit duhet të ruhet e njëjta pikëpamje apo këndvështrim, pra subjekti i njëjtë, forma foljore, veta, numri e të tjera të ngjashme.

➤ Shumë kujdes në përzierjen e konstrukcioneve të ndryshme në fjali, në vendosjen e fjalëve në vende të gabuara brenda fjalive, mospërdorimin e lidhëses etj.

➤ Madhësia e shkronjave rekomandohet të jetë 12, ndërkohë që largësia midis rreshtave 1.5 dhe mos bëni asnjë ndryshim për ndonjë paragraf.

➤ Gjerësia e marxhinave duhet të jetë e njëjtë në të katër anët e faqes (nëse projekt propozimi lidhet, të llogaritet hapësira që do të zërë lidhja dhe e njëjta ti shtohet anës përkatëse)

➤ Përdorni komandën 'Justify' (Ctrl+J), për tërë brendinë e projektit tuaj. Kjo krijon një dukje më estetike dhe më të qartë të përmbajtjes.

Ekzistojnë disa formate të ndryshme të shkrimit të bibliografisë, të cilat varen prej natyrës së shkrimit, llojit të lëndës por edhe prej autorit/rëve dhe sistemit për të cilin ai/ata përcaktohen.

Më poshtë janë disa udhëzime të përgjithshme për shkrimin e përmbajtjes së bibliografisë :

- * Mos vendosni numër në listën e bibliografisë
- * Organizoni punimet e të njëjtit autor (kur ka më tepër se një titull) sipas vitit të botimeve të tyre dhe jo sipas titullit.

Për një autor. Shembull :

Nushi, P., (2005). *Psikologjia e përgjithshme*. Prishtinë, Libri shkollor.

Për dy autorë. Shembull :

Bredacamp, S. & Copple, C. (1997). *Developmentally appropriate practices in early childhood programs*. Revised Edition. Washington, DC:NAEYC

Kur autori nuk është përmendur. Shembull :

Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë, 3-6 vjeç. (2006). Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. LIBRI SHKOLLOR, Prishtinë .

Për enciklopedi. Shembull :

Enciklopedia Britanike, (1997). Volumi 7, 'Gorillas', f. 50-51

Për revistë. Shembull :

Pica, R., (1997). *Beyond physical development : Why young children need to move*. *Young Children*, 52(6),4-11

Për gazetë. Shembull :

Shala, M., (2005). *Aktiviteti lëvizor në fëmijëri*. *Shkëndija*, Prishtinë, Nr. 9, fq.7

Për tezë të pabotuar.(Magjistrature apo Dokorate) Shembull :

Rose, B. (1994). *The importance of Gross Motor Coordination in the Psycho-social lives of Children*. Unpublished PhD Thesis. University of Western Australia.

Për intervistë. Shembull :

Arta Berisha. *Juriste*. 19 Mars 2009

Për film. Shembull :

Braveheart, (1950). Dir. Mel Gibson, *Icon Productions*.

Për CD. Shembull :

Compton's Multimedia Encyclopedia: Macintosh version, (1995). "Civil rights movement," p.3. Compton's Newsmedia.

Burimet online

Burimet online vendosen gjithmonë në fund të listës së bibliografisë.

Internet. Shembull :

Ellen Block, (15 Shtator,1995). New Winners. *Teen Booklist* (Online). Helen Smith@wellington.com

World Wide Web:

<http://www.boston.com>. Today's News, 1 Gusht, 1996

<http://www.nethelp.no>. 12 Mars 2007.



REKTOR
Acad.Prof.Dr.Arian R.IDRZAJ MD.
